

VENDIM
Nr.1203, datë 11.12.2009

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT
RRUGOR KALIMASH-MORINË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Kalimash-Morinë.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 407 (katërqind e shtatë) m² tokë truall, me vlerë 823 361 (tetëqind e njëzet e tre mijë e treqind e gjashtëdhjetë e një) lekë, për objekte, me vlerë 28 791 625.25 (njëzet e tetë milionë e shtatëqind e nëntëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e njëzet e pesë pikë njëzet e pesë) lekë, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi 29 614 986.25 (njëzet e nëntë milionë e gjashtëqind e katërmëdhjetë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e gjashtë pikë njëzet e pesë) lekë.

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 256 000 (dyqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 29 614 986.25 (njëzet e nëntë milionë e gjashtëqind e katërmëdhjetë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e gjashtë pikë njëzet e pesë) lekë, të përballohet nga “Llogaria e veçantë” e Ministrisë së Financave, pranë Bankës së Shqipërisë, “Fondi i shpronësimeve”.

6. Shpronësimi të fillojë më 15.12.2009 dhe të përfundojë më 15.3.2010.

7. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmim nga ZRPP”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve. Për objektet, pronarët, përveç dokumentacionit të pronësisë, duhet të paraqesin dhe dokumentacionin tekniko-ligjor.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të bëjë likuidimin e pronarëve brenda afateve të përcaktuara në pikën 3 të këtij vendimi, në bazë të dokumentacionit të pronësisë. Për objektet, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të bëjë likuidimin e pronarëve, në bazë të dokumentacionit ligjor të pronësisë dhe në bazë të dokumentacionit tekniko-ligjor.

9. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
 DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
 SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “KALIMASH-MORINË”

Nr.	Pronari			Zk	Nr.pas	Truall			Objekte vlere lekë	Totali lekë	Vendndodhja	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri			Sip.m ²	Çmimi m ²	Vlera lekë				
1	Abedin	Rasim	Oruçi	1543	157/2;157/3	292	2023	590716	25757107	26347823	Lagjja drinas	Konfirmuar nga ZRPP
2	Habibe	Ahmet	Oruçi	1543	157/4	115	2023	232645		232645	Lagjja drinas	Konfirmuar nga ZRPP
3	Bashkim	Selman	Cenaj	2315	41/28				306238	306238	Qytet kukës	Konfirmuar nga ZRPP
4	Vesel	Adem	Dida	1176	297/4				2728280.25	2728280.25	Breg-lum	Konfirmuar nga ZRPP
	Totali					407		823361	28791625.25	29614986.25		

